



UNMIK/REG/2005/8  
23 shkurt 2005

---

**RREGULLORE NR. 2005/8**  
**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI AKTIVITETET KËRKIMORE –**  
**SHKENCORE TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

Në harmoni me kapitullin 8 dhe të neneve 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 21 tetor 2004 lidhur me Ligjin mbi aktivitetet kërkimore-shkencore të miratuar nga Kuvendi më 27 shtator 2004,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo pushtetin dhe kompetencat e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi aktivitetet kërkimore-shkencore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/42), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që kudo që përdoret shprehja “kombëtar”, “shteti” dhe “Kosova” në tekstin e Ligjit të fshihen dhe të zëvendësohen me “Kosovë”. Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 23 shkurt 2005.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm